



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

B.Curri më 18.01.2018

SHPALLJE

PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE PËR POZICIONIN

Specialist I Planifikimit e Zhvillimit Territorit

Niveli minimal i diplomës minimumi Master professional diplomuar ne Inxhinjeri ndërtimi, arkitektur ose hidroteknik .

Kategoria IV-a

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tropojë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

.Kërkohen 2 (dy) Specialistë në Drejtorinë e P.ZH.T, në Bashkinë Tropojë, kategoria IV-a.

.Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë

Afati I fundit për dorëzimin e dokumentave për **LEVIZJE PARALELE: 29.01.2018**
Afati I fundit për dorëzimin e dokumentave për **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:**
02.02.2018

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

- 1-Përgjigjet para përgjegjësit të sektorit PZHT për menaxhimin e çështjeve që lidhen me fushen e planifikimit e zhvillimit territorit në përputhje me ligjet,aktet nënligjore apo aktet rregullore në fuqi
- 2-Kryen pune specifike te sektorit PZHT brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektet dhe afatet përfundimtare të detyrave.
- 3-Realizon detyrat në përputhje me politikat e institucionit me standartet administrative dhe procedurat teknike,si dhe duke mbajtur parasysh praktikat më të mira profesionale.
- 4- Planifikon dhe përmbush detyrat e ngarkuara në mënyrë profesionale dhe të pavarur.
- 5-Identifikon mundësit për përmirsimin e mëtejshem të procedurave dhe teknikave të perdorura në përmbushjen e detyrave.
- 6-Përgatit ne koh dhe me cilësi matrialet teknike dhe informon në kohe eproret për këto matriale
- 7-Përgatit raporte periodike dhe informon eproret për ecurin e punës në fushen e punes tij
- 8-Zbaton Rekomandimet apo sugjerimet e eproreve me qëllim përmirsimin e praktikave apo procedurave të zbatuara.
- 9-Diskuton rezultatet e punës me eproret dhe ja referon atije vetëm në rastet e çështjeve jo të zakonshme.
- 10-Respekton të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore dhe dokumentimin,administrimin dhe ruajtjen e dokumentave që administron apo punon.
- 11-Kryen çdo detyrë tjetër që i caktohet nga përgjegjësi i sektorit gjithmonë në lidhje me fushen e veprimtaris të sektorit ku bën pjesë.
- 12-Zgjidh problemet brenda politikave,parimeve dhe objektivave të përcaktuara për funksionin përkatës duke patur parasysh se zgjidhjet e dhëna ndikojne në punen e kolegeve dhe të njësise organizative përkatëse në të cilen punon.
- 13-Raporton dhe përgjigjet direkt para përgjegjësit të sektorit dhe veprimtaria e tij ndikon dhe reflektohet direkte në të gjithë veprimtarine e sektorit përkatës.
- 14-Kryen te gjitha detyrat qe percaktohen ne rreguloren e brendshme te institucionit qe ka te bejne me funksionin e tije
- 15-Specialisti drejtohet në mënyrë të përgjegjëshme nga përgjegjësi i sektorit.
- 16-Mund ti kërkohet në raste të veçanta apo urgjente të punoje jashtë orarit zyrtar të punës , të shtuna apo të diela apo në ditë festash zyrtare.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire” .

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë te nivelit master professional në fakultetin Inxhinjeri ndërtimi,deget :ndërtim/konstruksion,Arkitekturë ose hidroteknikë.
- Të ketë vjetërsi pune minimum 1 vit në profesion
- **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë (sekertari arkivit) Bashkisë Tropojë, dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopjet e diplomës kërkuar , nëse studimet janë kryer jashtë vendit diploma duhet të dorëzohet edhe njesimi I diplomes nga Ministria e Arsimit dhe sporteve.;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë, brenda datës 29.01.2018 .

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **31.01.2018**/njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Tropoje do të shpallë në stenden e informacinit Bashkise të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e verifikimit paraprake te kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).ne daten **08.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidateve qe renditen te kualifikuar,Ndersa po ne kete date njoftohet,vendi data,dhe ora e zhvillimit intervistes strukturuarme gojë.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Kodi i Procedurave Administrative;
- 4-Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

- 5- Ligji nr.107/2014”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar
- 6-Ligji nr.8402 dt.10.0901998 “ Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.
- 7-V.K.M. nr 408 dt.13.05.2015 ”Për miratimin e rregullorese Zhvillimit territorit” i ndryshuar.
- 8-Ligji për kodin e etikës në administratën publike

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.(i cili përfshinë përvojën, trajnimet, kualifikimet, e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin **pozitiv**.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen **me 60** pikë të mundëshme në lidhje me njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës , eksperiencën e tyre të mëparshme,motivimin,aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

• DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për rezultatet e konkurrentëve fitues do të shpallet në stenden e informacionit të Bashkisë Tropoje dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar të Punësimit” Ndersa kandidatet që nuk kualifikohen do njoftohen në menyr elektronike nepermes e_mail për rezultatin e arritur.

2.-PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.Këtë informacion do ta merrni në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë duke filluar nga data **08.02.2018** e në vazhdim.

2.1- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formësë prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplom te niveit master professional në Inxhinjeri ndërtimi degët, Nderetim, arkitekturë ose hidroteknikë.
- Të ketë eksperience pune të pakten 1 vitë në profesion.

2.2- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës Kerkuar se bashku me listen e notave Nese studimet jan kryer jashte vendit duhet qe te percillet edhe njehsimi I diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje te listes notave per arsimin e perfunduar
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- Vetedeklaime që nuk është përjashtuar me mas disiplinore nga shërbimi civil
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë zyrës sekertari arkivit , Bashkia Tropojë , dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar, Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **02.02.2018**

2.3- REZULTATET PËRFAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.02.2018** Bashkia Tropoje do të shpallë në Stenden e informacionit Bashkise Tropojë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listen paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Tropoje, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail). Ndërsa me dt.**22.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidateve që kualifikohen për vazhdimin e mëtejshem të konkursit, në këtë listë

do të njoftohet edhe vendi data dhe ora e saktë e zhvillimit testimit me shkrim dhe intervistës strukturuar me gojë , të kandidatëve që janë kualifikuar për vazhdimin e konkursit.

2.4- FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Njohuri mbi kodin e etikës ne administratën publike;
- 4-Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”,
- 5- Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar
- 6-Ligji nr.8402 dt.10.0901998 “ Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.
- 7-V.K.M. nr 408 dt.13.05.2015 ”Per miratimin e rregullorese zhvillimit te territorit” i ndryshuar.
- 8-Ligji për kodin e etikës në administratë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 -MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6- DATA E DALJES SË REZUL TATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në “portalin e shërbimit kombëtar të punësimit ” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive: për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi; Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të

vazhdueshme Stenden e informacionit Bashkise Tropoje dhe “Portalin e sherbimit kombetar te punesimit” duke filluar nga data **12.02.2018**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Tropoje do të shpallë fituesin në Stenden e informacionit Bashkise dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë që nuk fitojnë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet e arritura (nëpërmjet adresës së e-mail).

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE